



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE AFATET KOHORE TË RAPORTEVE DHE PASQYRAVE FINANCIARE TË NDËRMJETME DHE VJETORE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE, FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT DHE DEPOZITARIT

Miratuar me Vendim Bordi nr. 123, datë 31.07.2024

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat lidhur me formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raportimit të pasqyrave financiare dhe raporteve të tjera të shoqërisë administruese, fondit të pensionit privat dhe depozitarit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (këtu e në vijim “Autoriteti”), në lidhje me:

- a) Pasqyrat financiare vjetore dhe pasqyrat financiare për periudha raportuese brenda vitit ushtrimor, me anë të të cilave shoqëria administruese informon Autoritetin dhe përdoruesit e tjerë të jashtëm në lidhje me gjendjen e saj financiare dhe rezultatet e aktivitetit sipas Shtojcës 1, pjesë integrale e kësaj rregulloreje;
- b) Pasqyrat financiare vjetore dhe pasqyrat financiare për periudha raportuese brenda vitit ushtrimor të fondit të pensionit privat, me qëllim informimin e Autoritetit dhe përdoruesve të tjerë të jashtëm rreth gjendjes financiare dhe rezultateve të aktivitetit të tij, sipas Shtojcës 2, pjesë integrale e kësaj rregulloreje;
- c) Raportet e aktivitetit të depozitarit sipas Shtojcës 3, pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 108, pika 7 dhe nenit 152, pika 6 të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”.

Neni 3
Përkufizimet

Termet e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, referuar në këtë rregullore si “Ligji”.

KREU II
FORMA DHE PËRMBAJTJA E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË
ADMINISTRUESE DHE FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT

Neni 4
Përgatitja e pasqyrave financiare

Shoqëria administruese duhet të hartojë dhe publikojë pasqyra financiare në përputhje me ligjin nr.76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, me dispozitat ligjore për kontabilitetin dhe në përputhje me standardet kontabël (SNRF) të pranuar ndërkombëtarisht.

Neni 5
Forma dhe përmbajtja e pasqyrave financiare të shoqërisë administruese

1. Pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë administruese duhet të përmbajnë:
 - a. Pasqyrën e bilancit;
 - b. Pasqyrën e fitim humbjeve;
 - c. Pasqyrën e fluksit të parasë;
 - ç. Pasqyrën e lëvizjeve të kapitalit të vet;
 - d. Pasqyrën e raportit të kapitalit;
 - dh. Pasqyrën detajimi i tarifave;
 - e. Pasqyrën e strukturës së aktiveve, depozita dhe llogari rrjedhëse;
 - ë. Pasqyrën e strukturës së aktiveve, titujve;
 - f. Pasqyrën e strukturës së aktiveve, obligacione qeveritare;
 - g. Pasqyrën e strukturës së aktiveve, obligacione të shoqërive dhe;
 - gj. Shënimet e pasqyrave financiare.

2. Përmbajtja dhe forma e pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë administruese janë përcaktuar në Shtojcën 1, e cila është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.
3. Shoqëria administruese depoziton në Autoritet raportin vjetor të kontrollit të brendshëm në lidhje me veprimtarinë e saj dhe fondit të pensionit që ajo administron.
4. Shoqëria administruese duhet të hartojë pasqyrën e fluksit të parasë të parashikuar në shkronjën c), të pikës 1, të këtij neni duke përdorur mënyrën sipas Shtojcës nr.1.

Neni 6

Forma dhe përmbajtja e pasqyrave financiare të fondit të pensionit privat

1. Pasqyrat financiare të fondit të pensionit privat duhet të përmbajnë:
 - a. Pasqyrën e aktiveve të fondit të pensionit privat;
 - b. Pasqyrën e veprimtarisë së fondit të pensionit privat;
 - c. Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto;
 - ç. Pasqyrën mbi kuotat e fondit të pensionit privat;
 - d. Pasqyrën e strukturës së investimeve me të gjitha pasqyrat përbërëse të saj:
 - i. tituj të listuar;
 - ii. obligacionet;
 - iii. tituj të tjerë;
 - iv. depozitat me afat;
 - v. investime të tjera;
 - vi. treguesit e portofolit.
 - dh. Pasqyrën e fitimeve (humbjeve) të realizuara të fondit;
 - e. Pasqyrën e fitimeve (humbjeve) të porealizuara të fondit;
 - ë. Tabelën e planeve të pensionit privat;
 - f. Tabelën e numrit të anëtarëve të fondit të pensionit privat;
 - g. Tabelën e numrit të anëtarëve të larguar nga fondi i pensionit privat;
 - gj. Tabelën e ndarjes së anëtarëve të fondit të pensionit privat sipas grupmoshave;
 - h. Tabelat e kontributeve të derdhura në fondin e pensionit privat;
 - i. Tabelën e ndarjes së anëtarëve të fondit të pensionit privat sipas gjinisë;
 - j. Tabelën e numrit të anëtarëve që marrin pension privat periodik;
 - k. Shënimet e pasqyrave financiare.
2. Përmbajtja dhe forma e pasqyrave financiare vjetore të fondit të pensionit privat janë përcaktuar në Shtojcën 2, e cila është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Neni 7

Përgatitja dhe depozitimi i pasqyrave financiare

1. Pasqyrat financiare të parashikuar në nenet 5 dhe 6, të kësaj rregulloreje do të përgatiten për vitin ushtrimor për gjendjen në 31 dhjetor dhe për periudhat raportuese gjatë vitit ushtrimor për gjendjen, në 31 mars, 30 qershor dhe 30 shtator të vitit ushtrimor.
2. Pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe fondit të pensionit privat duhet të përgatiten dhe të depozitohen për vitin ushtrimor dhe për periudhat raportuese gjatë vitit ushtrimor me përmbajtje dhe formë të njëjtë me raportet financiare të referuara në nenet 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje.
3. **Përbashkësisht parashikimit të pikës 2 të këtij neni**, shënimet në pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe fondit të pensionit që administrojnë, për periudhat raportuese brenda vitit ushtrimor, duhet të paraqesin vetëm ngjarjet e rëndësishme të aktivitetit dhe ndryshimet në politikat kontabël, në lidhje me pasqyrat më të fundit financiare vjetore të publikuara.

Neni 8

Afatet për depozitimin e pasqyrave financiare në Autoritet

1. Afatet për depozitimin e pasqyrave financiare të shoqërisë administruese dhe fondit të pensionit privat, për periudhat raportuese gjatë vitit të aktivitetit do të jenë si vijon:
 - a. për periudhën tremujore me gjendjen deri më 31 mars të vitit aktual, deri më 15 prill të vitit aktual;
 - b. për periudhën gjashtëmujore me gjendjen deri më 30 qershor të vitit aktual, deri më 15 korrik të vitit aktual;
 - c. për periudhën nëntëmujore me gjendjen deri më 30 shtator të vitit aktual, deri më 15 tetor të vitit aktual.
2. Afati i fundit për depozitimin e pasqyrave financiare vjetore të paaudituar të shoqërisë administruese dhe fondit të pensionit që administrojnë, me gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit aktual është 15 janari i vitit pasardhës.
3. Afati i fundit për depozitimin e pasqyrave financiare vjetore të audituar të shoqërisë administruese dhe fondit të pensionit që administrojnë, me gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit aktual është 30 prilli i vitit pasardhës.
4. Afati i fundit për depozitimin e pasqyrave të konsoliduara financiare vjetore të audituar

me gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit aktual është 30 qershori i vitit pasardhës.

5. Shoqëria administruese depoziton në Autoritet, raportin vjetor të kontrollit të brendshëm në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë dhe fondit të pensionit privat që administrojnë brenda muajit janar të çdo viti pasardhës.

Neni 9

Mënyra e depozitimit

1. Pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe fondit të pensionit privat, duhet të depozitohen me shkrim pranë Autoritetit si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë link-ut të vënë në dispozicion në faqen zyrtare të Autoritetit për këtë qëllim, brenda afateve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 8, të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria administruese duhet të depozitojë me shkrim në Autoritet, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të nenit 8 si më poshtë:
 - a. pasqyrat e audituara financiare vjetore të shoqërisë administruese dhe të fondit të pensionit privat;
 - b. raportin nga shoqëria audituese për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë administruese dhe veprimtarisë së fondit të pensionit privat;
3. Shoqëria administruese duhet të depozitojë me shkrim në Autoritet, brenda muajit qershor të vitit pasardhës raportin vjetor.
4. Në rast se nga raporti i auditimit rezulton se të dhënat ndryshojnë nga ato të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të paaudituar, të shoqërisë administruese dhe fondit të pensionit privat, të depozituara brenda afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 8, shoqëria administruese do të depozitojë pasqyrat financiare vjetore me ndryshimet e pësuar nga raporti i auditimit brenda afatit të referuar, në pikën 3, të nenit 8, të kësaj rregulloreje.
5. Përfundimisht nga pika 1 e këtij neni, shoqëria administruese duhet të depozitojë me shkrim pranë Autoritetit pasqyrat e konsoliduara financiare vjetore të audituara, raportin e shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë administruese dhe veprimtarisë së fondit të pensionit privat dhe raportin vjetor.

Neni 10

Hartuesi dhe depozituesi i pasqyrave financiare

1. Shoqëria administruese është përgjegjëse për hartimin dhe depozitimin e të gjitha pasqyrave financiare të veprimtarisë së shoqërisë administruese dhe fondit të pensionit privat, të përcaktuara në Shtojcat 1 dhe 2, të kësaj rregulloreje, si edhe për hartimin dhe depozitimin e informacioneve shtesë që mund të kërkojë Autoriteti në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë administruese dhe/ose fondin e pensionit privat.
2. Pasqyrat financiare të shoqërisë administruese dhe pasqyrat financiare të fondit të pensionit privat duhet të jenë të nënshkruara nga drejtori i financës dhe administratori i shoqërisë administruese.

Neni 11

Mbajtja e kontabilitetit dhe auditimi i pasqyrave financiare

1. Shoqëria administruese mban libra dhe evidenca kontabël të sakta, të plota e të përditësuara, harton dhe publikon pasqyra financiare për veprimtarinë e saj dhe të fondit të pensionit privat që administron në përputhje me ligjin nr.76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, dhe me dispozitat ligjore që rregullojnë kontabilitetin dhe në përputhje me standardet kontabël (SNRF) të pranuar ndërkombëtarisht.
2. Pasqyrat vjetore financiare të shoqërisë administruese dhe fondit të pensionit privat do të auditohen nga shoqëri auditimi të miratuara nga Autoriteti.

Neni 12

Publikimi i pasqyrave financiare

1. Shoqëria administruese do të publikojë pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe pasqyrat financiare vjetore të fondit të pensionit privat që administron, në faqen e saj të internetit, brenda 15 ditëve nga data e miratimit nga asambleja e aksionarëve, por jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik në përputhje me rregullat për kontabilitetin dhe në përputhje me standardet kontabël (SNRF) të pranuar ndërkombëtarisht.
2. Shoqëria administruese publikon, për fondin e pensionit privat, pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe pasqyrat financiare për periudhat raportuese gjatë vitit ushtrimor në faqen e saj të internetit, brenda afateve të përcaktuara në nenin 8, të kësaj rregulloreje.

3. Shoqëria administruese brenda 7 ditëve pune publikon, raportin mujor të muajit paraardhës mbi veprimtarinë e secilit nga fondet e pensionit privat nën administrim.
4. Shoqëria administruese duhet të mbajë të publikuara në faqen e saj të internetit, pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe pasqyrat financiare të fondit të pensionit privat për periudhat raportuese të ndërmjetme gjatë vitit ushtrimor.

KREU III

RAPORTE MBI AKTIVITETIN E DEPOZITARIT TË FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT

Neni 13

Raportet e depozitarit

1. Raportet mbi aktivitetin e depozitarit të fondit të pensionit privat janë:
 - a. Raporti mbi vlerësimin e aktiveve të fondit të pensionit dhe llogaritjen e vlerës neto të aktiveve për kuotë të fondit të pensionit privat për të cilat depozitari ofron shërbime;
 - b. Raporti mbi saktësinë e metodave dhe rezultateve të vlerësimit të aktiveve të fondit të pensionit privat për të cilat depozitari ofron shërbime ;
 - c. Raporti mbi devijimin nga struktura e synuar e investimeve të fondit të pensionit privat për të cilat depozitari ofron shërbime;
 - d. Raporti mbi portofolin e investimeve të aktiveve të fondit të pensionit privat.
2. Forma dhe përmbajtja e raporteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni janë të përcaktuara në Shtojcën 3, e cila është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Neni 14

Raportimi i depozitarit në Autoritet

1. Raportet mbi vlerësimin e aktiveve të fondit të pensionit dhe llogaritja e vlerës neto të aktiveve për kuotë do të përgatiten nga depozitari për fondin e pensionit privat, për të cilin ai ofron shërbime dhe dërgohen në Autoritet, me anë të postës elektronike, si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit në link-un e vënë në dispozicion në faqen zyrtare të Autoritetit për këtë qëllim, çdo ditë, brenda orarit zyrtar të ditës kur bëhet vlerësimi, për ditën e vlerësimit (t-1).
2. Depozitari depoziton me shkrim në Autoritet, me anë të postës elektronike, si dhe në formë

elektronike nëpërmjet sistemit në link-un e vënë në dispozicion në faqen zyrtare të Autoritetit, brenda 3 ditë pune të muajit pasardhës, të dhënat ditore, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, për të gjithë muajin paraardhës.

3. Depozitari depoziton me shkrim në Autoritet, me anë të postës elektronike, si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit në link-un e vënë në dispozicion në faqen zyrtare të Autoritetit, të dhënat për portofolin e investimeve të aktiveve të fondit të pensionit, për vlerën nominale dhe kontabël të këtyre aktiveve si dhe për datën e maturimit të instrumenteve financiarë që përbëjnë portofolin e investimeve.
4. Depozitari raporton në Autoritet të dhënat për portofolin e investimeve, brenda datës 15 të muajit pasardhës, pas përfundimit të çdo tremujori të vitit..
5. Raportet e parashikuara në nenin 13, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” të kësaj rregulloreje, përgatiten nga depozitari dhe depozitohen me shkrim në Autoritet, brenda 3 ditë pune të muajit pasardhës pa vonesë.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Neni 17

Shfuqizimi

Me miratimin e kësaj rregulloreje, rregullorja nr. 25, datë 23.02.2011 "Për raportimin në AMF të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit", shfuqizohet.

Shtojca 1 - Pasqyrat financiare së shoqërisë administruese të fondit të pensionit

Informacioni	Përshkrimi, vlera
Kodi i shoqërisë administruese	
Numri i regjistrimit në QKR	
Numri për raportimin	
Adresa	
Telefon dhe fax	
E-mail:	
Faqe Web	
Data e licencimit	
Emri dhe mbiemri i Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Administrativ	
Pesë aksionarët më të mëdhenj (emri, mbiemri, adresa, ose emri i shoqërisë dhe adresa e zyrtare, përqindja e aksioneve në pronësi)	
Numri i punonjësve	
Shoqëria e ekspertit kontabël që ka audituar e fundit pasqyrat financiare	
Banka (depozitari) me të cilin kryen veprimet shoqëria administruese	
Numrat e llogarisë	

Shtojca 1 - Pasqyrat financiare të shoqërisë administruese

1. Pasqyra e Bilancit

Emri i shoqërisë administruese: _____

Kodi i shoqërisë administruese: _____

Për datën: _____

AKTIVI	Lekë	Lekë
	Data e vitit paraardhës	Data e vitit ushtrimor
A. Aktive afatgjata (I+II+III+IV)		
I. Aktive afatgjata materiale (1+2)		
1. Toka dhe Ndërtesa		
2. Të tjera aktive afatgjata materiale		
II. Aktive jo-materiale		
III. Aktive financiare(1+2+3+4)		
1. Depozita bankare		
2. Investime financiare të mbajtura përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse		
3. Investime financiare të mbajtura deri në maturim (kosto të amortizuar)		
4. Të tjera aktive financiare afatgjata		
IV. Investimet që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto		
B. Aktivi tatimor i shtyrë		
C. Aktive afatshkurtra (I+II+III+IV+V+VI)		
I. Pajisje në magazinë, inventar i imët dhe pajisje të tjera		
II. Llogari të arkëtueshme tregtare (1+2+3+4)		
1. Llogari të arkëtueshme nga fondet e pensioneve dhe investimeve		
2. Llogari të arkëtueshme nga shumat e paguara tepër, bazuar në fitim		
3. Llogari të arkëtueshme nga shteti dhe institucione të tjera		
4. Të tjera llogari të arkëtueshme		
III. Aktive financiare (1+2+3+4)		
1. Depozita bankare		
2. Të tjera aktive dhe llogari të arkëtueshme afatshkurtër të mbajtura përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse		
3. Të tjera aktive dhe llogari të arkëtueshme afatshkurtër të mbajtura deri në maturim (kosto të amortizuar)		
4. Kuota në fonde investimi		
IV. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (1+2)		
1. Llogari rrjedhëse dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në bankë		
2. Mjete monetare në arkë		
V. Shpenzime të parapaguara		
VI. Të ardhura të llogaritura		

D. Totali i Aktiveve(A+B+C)		
PASIVI	Lekë	Lekë
	Data e vitit paraardhës	Data e vitit ushtrimor
A. Kapitali (I+II+III+IV+V+VI)		
I. Kapitali i nënshkruar		
II. Rezerva të kapitalit		
III. Rezerva e rivlerësimit		
IV. Rezerva të tjera		
V. Fitime / humbje të mbartura		
VI. Fitimi / humbja neto për periudhën		
B. Detyrime afatgjata (I+II+III)		
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit dhe investimeve		
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi		
III. Detyrime të tjera afatgjata		
C. Detyrim tatimor i shtyrë		
D. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe		
E. Detyrime afatshkurtra (I+II+III+IV+V)		
I. Detyrime ndaj fondeve të pensionit dhe investimeve		
II. Detyrime të lidhura me hua dhe kredi		
III. Llogari të pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme		
IV. Shpenzime të shtyra		
V. Të ardhura të marra në avancë		
F. Totali i pasivit (A+B+C+D+E)		

2. Pasqyra e Fitim / Humbjeve

Emri i shoqërisë administruese: _____

Kodi i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

	Lekë	Lekë
	Periudha e mëparshme	Periudha ushtrimore
I. Të ardhura nga administrimi i fondit (1+2+3)		
1. Tarifa të administrimit		
2. Tarifa të largimit nga fondi		
3. Tarifa të tjera		
II. Shpenzime nga administrimi i fondit (1+2+3+4)		
1. Shpenzime të transaksioneve		
2. Shpenzime të marketingut		
3. Shpenzime të shitjes me agjent		
4. Shpenzime të tjera të administrimit të fondit		
III. Fitim / Humbja nga administrimi i fondit të pensionit/investimeve (+/-) (I-II)		
IV. Të ardhura të tjera		
V. Shpenzime të veprimtarisë së shoqërisë administruese (1+2+3+4+5+6)		
1. Shpenzime për materiale		
2. Shpenzime për personelin		
3. Amortizim i aktiveve materiale afatgjata/ jo materiale afatgjata		
4. Rregullim i vlerës së aktiveve afatshkurtra		
5. Provigjone për shpenzime dhe rreziqe		
6. Shpenzime të tjera të veprimtarisë		
VI. Të ardhura financiare		
VII. Shpenzime financiare		
VIII. Fitim / Humbja para tatimit (III+IV-V+VI-VII)		
IX. Tatimi mbi fitimin		
X. Fitim / Humbja neto për periudhën (VIII-IX)		

3. Pasqyra e Fluksit të Parave

Emri i shoqërisë administruese: _____
 Kodi i shoqërisë administruese: _____
 Për periudhën: _____

	Lekë	Lekë
	Periudha e mëparshme	Periudha e raportimit
a. Arkëtime nga veprimtaria shfrytëzuese		
b. Pagesa për veprimtarinë shfrytëzuese		
c. Flukse monetare neto nga veprimtaria shfrytëzuese (a - b)		
d. Arkëtime nga veprimtaria investuese		
e. Pagesa për veprimtarinë investuese		
f. Flukse monetare neto nga veprimtaria investuese (d - e)		
g. Arkëtime nga veprimtaria financuese		
h. Pagesa për veprimtarinë financuese		
i. Fluksi monetar neto nga veprimtaria financuese (g - h)		
j. Rritja/rënia neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (c+f+i)		
k. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim të periudhës kontabël		
l. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të periudhës kontabël (j+k)		

4. Pasqyra e ndryshimit të kapitalit

Emri i shoqërisë administruese: _____
 Kodi i shoqërisë administruese: _____
 Për periudhën: _____

	Lekë	Lekë	Lekë	Lekë
	Data e vitit paraardhës	Rritje	Zbritje	Data e vitit ushtrimor
I. Kapitali i nënshkruar				
II. Prime për aksione të emetuara				
III. Rezerva e rivlerësimit				
IV. Rezerva të tjera				
V. Fitime (humbje) të mbartura				
VI. Fitimi (humbja) e periudhës ushtrimore				
VII. Pagesat e dividendit				
VIII. Ndryshime në politikat kontabël dhe korrigjime				
IX. Ndryshime të tjera në kapital				
TOTALI I KAPITALIT (I+II+III+IV+V+VI+VII+VIII+IX)				

*Në sistem nuk do shfaqet kolona e periudhës së mëparshme të raportimit. Shoqëritë administruese do plotësojnë të dhënat për periudhën aktuale të raportimit.

5. Pasqyra e raportit të kapitalit

Emri i shoqërisë administruese: _____
 Kodi i shoqërisë administruese: _____
 Për periudhën: _____

Emërtimi	Vlera
Kapitali fillestar	15,800,000
Më pak ose i barabartë me	31,600,000,000
Aktive nën administrim	
Diferenca	(llogaritet automatikisht me formulë)
Rritja me 0.02% të tejkalimit	(llogaritet automatikisht me formulë)
Kërkesa ligjore e kapitalit	(llogaritet automatikisht me formulë)

6. Pasqyra e shpenzimeve fikse

Emri i shoqërisë administruese: _____
 Kodi i shoqërisë administruese: _____
 Për periudhën: _____

Shpenzime Fikse (Emërtimi i zërave) *	Vlera (Lekë)
Totali i shpenzimeve fikse	

*Shpenzimet fikse sipas nenit 5 të rregullores nr.3, datë 31.01.2024 “Për përcaktimin e kërkesave mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, formën, llogaritjen dhe shumën e fondeve të veta që duhet të ketë shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat”.

7. Pasqyra e detajimit të tarifave

Emri i shoqërisë administruese: _____
 Kodi i shoqërisë administruese: _____
 Për periudhën: _____

Emri i fondit	Lloji i fondit	Tarifa e administrimit

8. Pasqyra e strukturës së investimeve

8.1 Pasqyra e strukturës së aktiveve, depozita dhe llogari rrjedhëse

Emri i shoqërisë administruese: _____

Kodi i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Pozicioni	Referenca	Maturiteti	Vlera në momentin e depozitimit	Vlera në datën e raportimit
Depozita afatgjatë				
Depozita afatshkurtër				
Llogari rrjedhëse				

8.2 Pasqyra e strukturës së aktiveve, titujt

Emri i shoqërisë administruese: _____

Kodi i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Pozicioni	ISIN	Maturiteti	Vlera nominale	Vlera e blerjes	Vlera në datën e raportimit
Bono thesari vendase					
Emetime të bankës qendrore vendase					
Dëftesa tregtare vendase					
Kuota në fonde vendase					
Tituj të tjerë vendas					
Bono thesari të huaja					
Emetime të bankës qendrore të huaj					
Dëftesa tregtare të huaja					
Kuota në fonde të huaja					
Tituj të tjerë të huaj					
TOTALI VENDASE					
TOTALI TË HUAJA					

8.3 Pasqyra e strukturës së aktiveve, obligacione qeveritare qendrore dhe vendore

Emri i shoqërisë administruese: _____

Kodi i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Pozicioni	ISIN	Qëllimi i mbajtjes	Shteti	Maturiteti	Vlera nominale	Vlera e blerjes	Vlera në datën e raportimit
Obligacione të qeverisë së RSH							
Obligacione bashkiake vendase							
Obligacione të qeverive të huaja							
TOTALI I OBLIGACIONEVE QEVERITARE QENDRORE DHE VENDORE							

8.4 Pasqyra e strukturës së aktiveve, obligacione të shoqërive

Emri i shoqërisë administruese: _____

Kodi i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Pozicioni	ISIN	Qëllimi i mbajtjes	Shoqëria	Maturiteti	Vlera nominale	Vlera e blerjes	Vlera në datën e raportimit
Obligacione shoqërishe vendase							
Obligacione shoqërishe të huaja							
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË SHOQËRIVE							

9. Shënime të pasqyrave financiare

Emri i shoqërisë administruese: _____

Kodi i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën:

Shënimet për pasqyrat financiare do të përgatiten në përputhje me kërkesat e SNRF-ve dhe do të:

- a. Paraqesin informacion rreth bazës së përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave specifike të kontabilitetit të përdorura, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 1 (IAS1);
- b. Ekspozojnë çdo informacion të kërkuar nga SNRF-të që nuk është paraqitur në pasqyrat financiare;
- c. Paraqesin informacion shtesë që nuk është paraqitur në pasqyrat financiare por që është i rëndësishëm për të kuptuar secilën prej tyre.

Data e raportimit:

Personi i autorizuar i shoqërisë administruese:

Përgatitur nga:

Detaje kontakti:

Shtojca 2 - Pasqyrat financiare të fondit të pensionit privat

*1. Pasqyra e aktiveve të fondit të pensionit privat

Emri i fondit të pensionit privat: _____

Kodi i fondit të pensionit privat: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

Zërat e aktivitetit	Lekë	Lekë
	Data e periudhës paraardhëse	Data e periudhës ushtrimore
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		
Investime (2.1+2.2+2.3+2.4)		
2.1 Tituj borxhi të blerë në emetimin e parë (2.1.a+2.1.b+2.1.c)		
2.1.a. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
2.1.b. Investime financiare përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse		
2.1.c. Investime financiare të mbajtura deri në maturim (kosto të amortizuara)		
2.2 Tituj borxhi të blerë në treg sekondar (2.2.a+2.2.b+2.2.c)		
2.2.a. Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes		
2.2.b. Investime financiare përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse		
2.2.c. Investime financiare të mbajtura deri në maturim (kosto të amortizuara)		
2.3 Depozita		
2.4 Tituj të tjerë (2.4.a +2.4.b)		
2.4.a. Aksione/Kuota në sipërmarrje të vetme të investimeve kolektive		
2.4.b. Tituj të tjerë		
3. Llogari të arkëtueshme (3a+3b+3c+3d+3e+3f)		
3a. Të arkëtueshme nga shitja e letrave me vlerë		
3b. Të arkëtueshme nga shoqëria administruese		
3c. Të arkëtueshme nga depozitari		
3d. Parapagime		
3e. Të arkëtueshme nga ndryshimi i anëtarësisë		
3f. Të tjera llogari të arkëtueshme		
A (1+2+3) TOTALI I AKTIVEVE		
4. Detyrime nga investimi në tituj		
5. Detyrime nga investimi në depozita		
6. Detyrime ndaj shoqërisë administruese		
7. Detyrime ndaj depozitarit		
8. Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë		
9. Pagesa të shtyra dhe të ardhura të marra në avancë		
10. Detyrime të tjera		

B (4+5+6+7+8+9+10) TOTALI I DETYRIMEVE		
C (A-B) AKTIVET NETO TË FONDIT TË PENSIONIT		
D NUMRI I KUOTAVE TË FONDIT TË PENSIONIT		
E (C/D) AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË PENSIONIT		

2. Pasqyra e veprimtarisë së fondit të pensionit privat

Emri i fondit të pensionit privat: _____

Kodi i fondit të pensionit privat: _____

Emri i shoqërisë administruese: _____

Për periudhën: _____

		Lekë	Lekë
Nr.	Zërat e aktivitetit	Periudha e mëparshme	Periudha ushtrimore
	TË ARDHURA NGA INVESTIMET		
1	Fitime të realizuara nga shitja e investimeve në tituj		
2	Të ardhura nga interesat		
3	Diferenca pozitive të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare		
4	Të ardhura nga dividendët		
5	Të ardhura nga interesat e depozitave		
6	Të ardhura të tjera		
A (1+2+3+4+5+6)	TOTALI I TË ARDHURAVE NGA INVESTIMET		
	SHPENZIMET		
7	Humbje të realizuara nga shitja e investimeve në tituj		
8	Diferenca negative të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare		
9	Tarifa për shoqërinë administruese		
10	Tarifa për depozitarin		
11	Shpenzime të tjera/provigjone		
B (7+8+9+10-11)	TOTALI I SHPENZIMEVE		
C (A-B)	FITIMI (HUMBJA) NETO NGA INVESTIMET, +/-		
	FITIMI (HUMBJA) E PAREALIZUAR NGA INVESTIMET NË TITUJ		
d1	Fitimi (humbja) e perealizuar nga investimet në tituj, +/-		
d2	Ndryshime neto prej kurseve të këmbimit në investimet në tituj		
